



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, si dhe nenit 2 të Memorandumit të Bashkëpunimit 1-320-48969 të datës 23.07.2019 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY", Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 26. 11. 2019, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

**V E N D I M**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE**

**Neni 1**

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 11,731.00 € (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e një euro), me destinim për subvencionimin – familjeve me kushte të rënda ekonomike në Komunën e Lipjanit për sigurimin e serrave bujqësore, motokultivatorëve, tufë delesh, shoqëri bletësh me qëllim të fuqizimit ekonomik të këtyre familjeve

II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën II të këtij Vendimi bëhet konform dispozitave të nenit 2 të Memorandumit të Bashkëpunimit 1-320-48969 të datës 23.07.2019 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" në të cilën përcaktohet që nga shuma e përgjithshme e projektit, Komuna e Lipjanit do të participojë me 10% nga vlera e projektit .

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga buxheti i Komunës- kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural .

IV.Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës

Nr.15- 400-75616

Lipjan, më 27. 11. 2019

**KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Daut Azemi**

